

Forumi i Politikave të Integritimit monitoron nga afër procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe institucionet e përfshira në të, duke u përqendruar kryesisht në koordinimin ndërinstucional ndërmjet njërive dhe dokumenteve dhe raporteve të tyre ligjore. Treguesit e monitorimit dhe rregullat metodologjike përfshijnë aktet normative dhe/ose legjislativ të miratuara; aktivitetet e kryera (numri i takimeve, plan-veprimeve, raportet, strategjitë për të adresuar mangësitë e identifikuar nga raporti i KE, etj.); fazën e zhvillimit paraprakisht të instrumenteve; si dhe shqyrtimin institucional dhe publik të rezultateve të arritura.

ZONA EKONOMIKE RAJONALE: NGA KONCEPTUALIZIMI TEK ZBATIMI

Baisa Sefa
EU Policy Hub

HISTORIKU: ZANAFILLA E ZONËS EKONOMIKE RAJONALE (REA) DHE LIDHJA E SAJ ME AXHENDËN E KONEKTIVITETIT

Zona Ekonomike Rajonale (REA) u prezantua gjatë Samitit të Triestes në 2017, në kuadër të procesit të Berlinit. Që prej fillimit, REA rezultoi të jetë iniciativa rajonale më dinamike, e cila sjellë së bashku 6 vendet anëtare të BE-së dhe 6 vendet kandidatë dhe potencial kandidatë nga Ballkani Perëndimor (BP6)¹, duke ofruar një impuls të ri në perspektivën e zgjerimit të BE-së në të gjithë rajonin. Pesë takimet diplomatike të nivelit të lartë, të organizuara në kuadër të procesit të Berlinit, rezultuan të jenë një mekanizëm efektiv për të mbajtur ritmin e zgjerimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor, duke siguruar rezultate të prekshme që mbështesin këto vende të përshtatet me standardet e BE-së.

Qëllimi kryesor i procesit të Berlinit është integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor midis njëri-tjetrit, si dhe integrimi i tyre në BE përmes zhvillimit të [Axhendës së Konektivitetit/Ndërlidhjes](#) (CA). Kjo axhendë përbëhet nga projekte

komplekse në fushën e infrastrukturës energjitike, transportit si dhe investimeve² për të lidhur vendet e Ballkanit Perëndimor me rrjetin kryesor të transportit evropian. Elementet e konektivitetit dhe bashkëpunimit rajonal kanë qenë gjithmonë të pranishme në strategjitë e zgjerimit pasi ato përbëjnë bazën e Procesit të Stabilizim-Asociimit (SAP). Një vëmendje të veçantë, këtyre elementëve iu kushtua sidomos në [Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2018](#), kur REA përmendet në mënyrë eksplicite. Historia ka treguar se Komisioni Evropian (KE) ka demonstruar në mënyrë të përsëritur mbështetjen e saj për strukturat dhe iniciativat me pronësi dhe drejtim rajonal³. Por vlera e shtuar e procesit të Berlinit konsiston në faktin që konektiviteti/ndërlidhja dhe bashkëpunimi rajonal kanë marrë rëndësi strategjike, duke u shndërruar nga instrumente në shërbim të Kriterëve të Kopenhagenit ose

² Krisela Hackaj & Gentiola Madhi, "[Si procesi i Berlinit do të afektojë pozitën ekonomike të Shqipërisë?](#)", janar 2016, fq. 6.

³ Si struktura dhe nisma me pronësi dhe drejtim rajonal mund të përmendim për shembull: Procesin e Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC), Strategjia e Evropës Juglindore (SEE) 2020, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CETFA) Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA), etj.

¹ Gjashtë shtetet anëtare të BE-së janë: Austria, Franca, Gjermania, Italia, Kroacia, Sllovenia. Ndërsa 6 vendet e Ballkanit Perëndimor janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

qëllimeve të axhendës së Selanikut, në qëllime *per se*⁴. Në thelb, siç është përmendur edhe në strategjinë e zgjerimit të këtij viti, konektiviteti dhe bashkëpunimi rajonal janë *de facto* parakusht për pranimin në BE.

Angazhimi i ndërmarrë nga vendet e Ballkanit Perëndimor në kuadër të procesit të Berlinit i referohet jo vetëm konektivitetit fizike, por mbi të gjitha konektivitetit njerëzor. Ky komponent është po aq i rëndësishëm sa edhe komponenti fizik, pasi duke pasur parasysh faktin që konektiviteti njerëzor përmirëson marrëdhëniet në rajon ai është me vlerë strategjike si për BE-në ashtu edhe për Ballkanin Perëndimor. Duke filluar nga samiti i parë, konektiviteti njerëzor - përfaqësuar nga mobiliteti/lëvizshmëria e të rinjve, profesionistëve, akademikëve dhe hulumtuesve - bëhet temë e përhershme e diskutimeve të samiteve ballkanike.

Roli i konektivitetit si nxitës i rritjes ekonomike, është pranuar nga BE-ja nëpërmjet mbështetjes së vazhdueshme financiare, si dhe vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilët e kanë shndërruar atë në një nga prioritetet e tyre më të rëndësishme, me theks të veçantë në përgatitjen dhe financimin e projekteve rajonale konkrete infrastrukturore. E përkthyer në shifra financiar [kostoja totale e bashkëfinancimit të projekteve të konektivitetit miratuar në Samitin e Triestes](#) arriti në vlerën e 535,8 milionë €, nga të cilat 194,1 milion € ishin grante të BE-së⁵. Ndërsa për vitin 2018, kjo kosto arrin në vlerën e 1034,5 milionë €, nga të cilat 190.2 milionë € do të jenë grante të BE-së⁶. Këta shembuj ilustrjnë mbështetjen e

padiskutueshme të BE-së në promovimin e mëtejshëm të konektivitetit rajonal.

Është e rëndësishme të theksohet se procesi i Berlinit bazohet në programet ekzistuese të financimit siç është Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF)⁷ për të mbështetur iniciativat rajonale që rrisin konektivitetin. Që nga viti 2009, WBIF ofron asistencë teknike dhe mbështetje financiare (nëpërmjet fondeve të BE-së dhe / ose kredive të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFI)) për investime strategjike në Ballkanin Perëndimor. [Statistikat tregojnë se WBIF](#) është shndërruar në një burim kryesor financimi në rajon, me një kontribut total prej 180 milion € nëpërmjet 33 granteve në 2017⁸. Transporti, energjia dhe mjedisi kanë marr numrin më të madh të granteve / projekteve⁹, të ndjekura nga sektori social dhe privat.

Konektiviteti rajonal u përforcuar në [Samitin e BERZH-it mbi Investimet në Ballkanin Perëndimor](#), në shkurt të vitit 2014. [Ky samit](#) përcoi një impuls të rëndësishëm, për sa i përket jo vetëm prezantimit të rajonit si një destinacion i përbashkët investimi, por edhe në transmetimin e mesazheve të forta politike rreth pjekurisë dhe stabilitetit të rajonit¹⁰. Si paraardhës i Samitit të Berlinit, kjo ngjarje i hapi rrugë thithjes së investimeve të huaja, aq shumë të nevojshme, dhe shndërrimin e integrimin rajonal në prioritet të axhendës së zgjerimit të BE-së.

SAMITET BALLKANIKE DHE RRUGA DREJT ZONËS EKONOMIKE RAJONALE (REA)

Samiti i parë i Ballkanit Perëndimor u thirr nga kancelarja Merkel në gusht të 2014 në

⁴ Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Raport "[Berlin Process Series](#)" [Procesi i Berlinit/3/2018](#), shkurt 2018, fq. 16.

⁵ [Akhenda e Konektiviteti - Bashkëfinancimi i Projekteve të Investimeve në Ballkanin Perëndimor 2017](#)

⁶ [Akhenda e Konektiviteti - Bashkëfinancimi i Projekteve të Investimeve në BP 2018](#)

⁷ Krisela Hackaj & Gentiola Madhi, "Si procesi I Berlinit do të afektojë pozitën ekonomike të Shqipërisë"? janar 2016, fq. 7.

⁸ WBIF 2017 Raporti Vjetor, fq.4.

⁹ *Ibid.* p.6.

¹⁰ "Forum i investimeve të Ballkanit Perëndimor në BERZH" 11 shkurt 2014, marrë më 24 janar 2018.

Berlin. Ky samit përcaktoi kuadrin e përgjithshëm në bazë të të cilit do të funksionojë procesi i Berlinit dhe diskutimi u përqendrua kryesisht në angazhimin politik dhe bashkëpunimin institucional të vendeve të Ballkanit Perëndimor¹¹. Bashkëpunimi rajonal, qeverisja e mirë dhe rritja ekonomike ishin disa nga temat e përfshira në axhendën e këtij samiti.

Samiti i dytë, organizuar në vitin 2015 në Vjenë, solli në qendër të vëmendjes [Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Dypalëshe](#)¹² midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Bazuar në [deklaratën përfundimtare të këtij samiti](#)¹³, rezultoi se axhenda e konektivitetit është e lidhur ngushtë me *qeverisjen ekonomike dhe Programet Kombëtare të Reformës Ekonomike (NERP)*, zbatimi i të cilave është një faktor kyç për të siguruar rritje të qëndrueshme për rajonin. Përforcimi i investimeve në rajon, nëpërmjet themelimit të Dhomës së Forumeve të Investimeve (CIF)¹⁴ ishte një nga çështjet kryesore të diskutuar në këtë samit.

Bashkëpunimi rajonal shënoi arritjen e tij të parë vetëm në Samitin e Parisit në 2016, me themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO). Aktualisht, RCOY konsiderohet si një nga arritjet më të suksesshme që promovon lëvizjen e të rinjve në rajon dhe nxit konektivitetin njerëzor.

Në Samitin e tretë të Ballkanit Perëndimor, organizuar në Trieste në vitin 2017, u riafirmua njëzëri perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor. Një vëmendje të veçantë në këtë samit, mori

integrimi rajonal përmes Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit të REA-s, konektiviteti, krijimi i [Komunitetit të Transportit](#)¹⁵ dhe [Deklarata e Përbashkët](#) kundër Korrupsionit. Zhvillimi i sektorit privat dhe SME-ve, dixhitalizimi i proceseve ekonomike dhe lidhja e tregjeve rajonale¹⁶ - thelbësore për gjenerimin e vendeve të punës dhe rritjen ekonomike - u përmendën specifikisht në Deklaratën Përfundimtare të Samitit të Ballkanit Perëndimor në Paris, duke nënvizuar rëndësinë e forcimit të lidhjeve ekonomike ndërmjet vendeve të rajonit në drejtim të thithjes së investimeve të huaja.

[Samiti i Londrës](#), i cili u organizuar më 10 korrik të 2018, u përqendrua kryesisht në bashkëpunimin politik, ekonomik dhe në fushën e sigurisë¹⁷. Për të mbështetur këto objektiva, [KE po përgatit një instrument të ri garancie që do të prezantohet në fillim të vitit 2019](#)¹⁸ nën WBIF. Me një angazhim fillestar të BE-së që arrin deri në 150 milionë €, në 2019-2020 garancia do BE do të alokoj për vendet e rajonit synon të arrij vlerën e 1 miliard € investime në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe integrimin rajonal¹⁹. [Rezultatet e Samitit të Londrës - tre deklaratat të përbashkëta](#) mbi (i) bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore, (ii) personat e zhdukur, (iii) krimet e luftës²⁰ - rikonfirmuan rëndësinë që komponenti i konektivitetit njerëzor ka për pajtimin rajonal dhe bashkëpunimin. [Samiti i ardhshëm do të organizohet në Poloni në](#)

¹¹ Deklarata Finale nga Kryetari i Konferencës për Ballkanin Perëndimor, 28 gusht 2018.

¹² Samiti i Ballkanit Perëndimor të Vjenës 2015, Shtojca 3, Bashkëpunimi Rajonal dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve Dypalëshe.

¹³ Deklarata Finale nga Kryetari i Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor, 27 gusht 2015.

¹⁴ CIF është një platformë rajonale e përhershme që mbledh së bashku dhomat e tregtisë së Ballkanit Perëndimor 8 (BP6 + Sllovenia dhe Kroacia) nën patronazhin dhe mbështetjen e dhomës së tregtisë dhe industrisë së Austrisë dhe Gjermanisë.

¹⁵ Traktati themelues i Komunitetit të Transportit, Gazeta Zyrtare e BE, 27.10.2017.

¹⁶ Deklarata Finale e Kryetarit të Samitit të Ballkanit Perëndimor të Parisit, 4 korrik 2016, fq. 5.

¹⁷ Zyra Britanike e Marrëdhënieve me Jashtë - Rreth Samitit të Ballkanit Perëndimor.

¹⁸ Komisioni Evropian, Komunikatë për shtyp "Samiti i Ballkanit Perëndimor në Londër - ndërtimi i lidhjeve më të forta brenda rajonit dhe BE", Londër, 10 korrik 2018.

¹⁹ *Ibid.*

²⁰ Deklaratat e Përbashkëta për Bashkëpunimin Rajonal dhe Marrëdhëniet e Fqinjësisë së Mirë nënshkruar në Takimin e Liderëve në Londër.


[vitin 2019](#)²¹. Deri atëherë objektivi kryesor është përforcimi i marrëdhënieve midis vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes projekteve infrastrukturore, bashkëpunimit ekonomik si dhe shkëmbimeve rinore.

Në kontekstin e procesit të Berlinit, përbërësi thelbësor për suksesin e bashkëpunimit rajonal lidhet me përkrahjen e fortë politike dhe pronësinë e rajonit në vizionin e përbashkët për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor dhe rolin proaktiv në ndërmarrjen e mekanizmave dhe platformave të përbashkëta. Në këtë këndvështrim, lidhshipi dhe pronësia e vendeve të rajonit, të kombinuara me mbështetjen e BE-së dhe Shteteve Anëtare, mbeten një parakusht për suksesin e mëtejshëm.

Prezantuar specifikisht në Samitin e Triestes, REA zërthehet në praktikë përmes Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit. REA ka për qëllim: mundësimin e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe punës së kualifikuar; transformimin e Ballkanit Perëndimor në një rajon më tërheqës për investime dhe tregti; dhe përsheptimin e konvergencës së vendeve të rajonit me BE-në duke sjellë prosperitet tek qytetarët e Ballkanit Perëndimor.

²¹ Konkluzionet e Kryetarit në Takimin e Kryetarëve të Samitit të Ballkanit Perëndimor në Londër, 10 korrik 2018.

Figura 1: Kalendar kronologjik i Samiteve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të procesit të Berlinit



ÇFARË ËSHTË REA DHE RËNDËSIA E SAJ NËN OPTIKËN E ANËTARËSIMIT NË BE

REA është zhvilluar me kërkesën e gjashtë kryeministrave të rajonit për të përgatitur një "... [propozim për një qasje të përbashkët për avancimin e bashkëpunimit ekonomik në Ballkanin Perëndimor](#)"²². Ndaj, pronësia në zhvillimin e kësaj zone ekonomike i takon plotësisht vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat janë të njohura me përfitimet e bashkëpunimit rajonal, kryesisht në fushën e transportit dhe energjisë.

Aktualisht, vendet e Ballkanit Perëndimor janë në një moment të rëndësishëm historik. Ndonëse dhjetëvjeçari i mëparshëm kishte sjellë një GDP-në për frymë të rajonit pothuajse 8.5% më afër mesatares së BE-së, kjo konvergjencë ka stopuar, duke e ngushtuar hendekun me vetëm 1% në gjysmën e parë të kësaj dekade²³. Edhe pse vendet e rajonit kanë ndërmarrë disa iniciativa për të adresuar dobësitë e brendshme strukturore, ato nuk janë të mjaftueshme²⁴. Ndaj është e

nevojshme krijimi i një strukture për zhvillimin e tregtisë së përbashkët rajonale, ku barrierat nuk ekzistojnë. Pikërisht këtu qëndron edhe fuqia transformuese e REA-s. Ajo i ndihmon ekonomitë e Ballkanit Perëndimor të forcojnë lidhjet midis tyre duke transformuar gjashtë ekonomi të vogla dhe të dobëta në një treg të përbashkët rajonal.

REA është në përputhje të plotë me të gjitha angazhimet që vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë në kuadër të CEFTA-s dhe ndihmon në zbatimin e tyre. Si e tillë, të gjitha masat e CEFTA-s pasqyrohen në dimensionin ekonomik të Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit të REA-së, përfaqësuar nga shtyllat e tregtisë dhe investimeve, të përshkruara më poshtë. Përveç tregtisë dhe investimeve, [Plani Shumë-Vjeçar i Veprimit](#) bazohet, gjithashtu, edhe në komponentët e mobilitetit dhe dixhitalizimit²⁵. Është e rëndësishme të kuptojmë se REA nuk ka të bëjë vetëm me krijimin e një tregu të përbashkët rajonal. Më shumë se kaq, REA synon heqjen e barrierave sociale në aspektin e mobilitetit/ lëvizshmërisë të profesionistëve, të të rinjve, aftësive dhe inovacionit. Është pikërisht dimensionin social që i atribuon vlerë të shtuar REA-s në

²² Deklaratë nga Takimi i Kryeministrave të Ballkanit Perëndimor, Sarajevë, 16 mars 2017.

²³ [Plani i konsoliduar Shumë-Vjeçar i Veprimit për një zonë ekonomike rajonale në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor](#), 6 korrik 2017.

²⁴ "Asnjë nga vendet e BP6 ende nuk konsiderohet të jetë një ekonomi tregu funksionale", Komisioni Evropian, Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komiteti i Rajoneve, [Strategjia e Zgjerimit të BE-së](#), COM (2018), COM(2018) 65 final, Strasburg, 6.2.2018, p. 3.

²⁵ Plani i konsoliduar Shumë-Vjeçar i Veprimit për një zonë ekonomike rajonale në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, 6 korrik 2017.

krahasim me CEFTA-n, e cila është specifikisht një marrëveshje ekonomike.

Vlen të përmendet se, REA nuk është një alternativë për integrimin në BE²⁶. Përkundrazi, duke krijuar një treg të përbashkët rajonal ku pengesat tregtare dhe sociale janë tërhequr, REA po kontribuon drejt një thellimi progresiv të integritit socio-ekonomik të Ballkanit Perëndimor brenda rajonit dhe BE-së. Në këtë kontekst, REA konsiderohet si një 'moment historik' në kuadër të përgatitjes të vendeve të Ballkanit Perëndimor për anëtarësim në BE.

Aktualisht, shpejtësia e procesit të anëtarësimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor ka qenë relativisht e ngadaltë. Përveç Serbisë dhe Malit të Zi, të identifikuar si vende për një anëtarësim të mundshëm në vitin 2025²⁷, për vendet e tjera një perspektivë e tillë duket të jetë larg. Në këtë kontekst, REA do të përshpejtojë zhvillimin ekonomik dhe procesin e anëtarësimit në BE të vendeve të rajonit duke mbështetur përpjekjet e tyre në drejtim të harmonizimit dhe respektimit të standardeve të BE-së.

Përkundër gatishmërisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor për të bashkëpunuar dhe për të ecur përpara me krijimin e REA-s, është thelbësore që BE-ja të mbështesë dhe lehtësojë zbatimin e Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit përmes instrumenteve / programeve aktuale të disponueshme, si dhe programeve të reja. Qëllimi - një e ardhme e përbashkët brenda BE-së - do të përfshijë më nga afër vendet e rajonit në vendimmarrje strategjike, veçanërisht në kontekstin e Kornizës së re Financiare Shumë-Vjeçare të BE-s. Në fund të fundit, BE-ja tashmë është e vetëdijshme për faktin se një rajon i fortë dhe i bashkuar është parakusht për një Evropë të fortë.

²⁶ Komisioni Evropian - [Fact Sheet](#), Bruksel, 12 korrik 2017.

²⁷ ['Gara e pengesave për anëtarësimin në BE: A është Shqipëria e ngadaltë dhe pse?](#), EU Policy Hub, fq. 12.

Në këtë drejtim, ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor e konsiderojnë REA-n si një trampolinë drejt anëtarësimit në BE dhe një moment historik në përmbushjen e kriterëve ekonomike të Kopenhagës²⁸. Në të vërtetë, REA rezulton të rikonfirmojë bazat e BE-së, duke u mbështetur para së gjithash, në një bashkëpunim ekonomik. Më shumë se një deklaratë politike, REA është një iniciativë e prekshme që nëpërmjet veprimeve origjinale, si: vendosja e një tregu të vetëm rajonal, shmangia e barrierave sociale, marrëveshjet e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe heqja e pengesave për mobilitetin e studentëve, i sjell vendet e rajonit më pranë anëtarësimit në BE.

Më konkretisht, Plani Shumë-Vjeçar i Veprimit (MAP) - instrumenti që materializon në praktikë REA-n - mbështetet në katër komponentë kryesorë:

➤ **Tregtia** - ka për qëllim krijimin e një zone ekonomike rajonale, në përputhshmëri me standardet e BE-së, për të mbështetur përpjekjet për thithjen e sa më shumë investimeve, për zvogëlimin e kostove të transaksioneve tregtar dhe për eliminimin e barrierat në treg, në mënyrë që të optimizohet kostoja e prodhimit. Qëllimi i saj është ta transformojë rajonin në një zonë ku mallrat, shërbimet, investimet dhe njerëzit e kualifikuar lëvizin lirisht pa tarifa, kuota apo barriera të tjera të panevojshme duke synuar njohjen e të gjitha dokumenteve kufitare, procedurave dhe programeve që lidhen me tregtinë.

➤ **Investimet** – konsiston në promovimin e rajonit si një destinacion unik investimi. Kjo përfshin shkëmbimin e informacionit

²⁸ [Plani i konsoliduar Shumë-Vjeçar i Veprimit për një zonë ekonomike rajonale në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor](#), 6 korrik 2017.

dhe praktikat më të mira mbi politikat e investimeve dhe identifikon politikat që mund të harmonizohen për të gjitha vendet e rajonit me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja. Gjithashtu, ky komponenti synon të stimulojë zhvillimin e sektorit privat në mënyrë që të maksimizohet përfitimi i REA-s për ekonomitë lokale, duke nxitur kështu integrimin e kompanive nga rajoni në zinxhirin e vlerave ndërkombëtare.

- **Mobiliteti** - synon të eliminojë pengesat për lëvizjen e personave të kualifikuar dhe të profesionistëve, nëpërmjet marrëveshjeve rajonale për njohjen e ndërsjellët të kualifikimeve profesionale. Gjithashtu, eliminimi i pengesave për mobilitetin/lëvizshmërinë e studentëve, studiuesve dhe akademikëve është një tjetër çështje në fokus të kësaj shtylle. Axhenda e Mobilitetit mbështetet në bashkëpunimin e përmirësuar në fushën e shkencës dhe industrisë, duke përfshirë transferimin e teknologjive dhe fillimin e start up-ve, platformave për edukimin e shkencëtarëve dhe inxhinierëve, etj.
- **Integrimi Dixhital** – konsiston në transformimin e mënyrës së të bërit biznes. Axhenda dixhitale e Ballkanit Perëndimor synon të lehtësojë integrimin e ekonomive rajonale në tregun e brendshëm dixhital evropian. Axhenda dixhitale mbulon çështje të tilla që kanë lidhje me roaming-un dhe zhvillimin e infrastrukturës broadband, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, aftësitë dixhitale dhe zhvillimin e teknologjive smart në rajonin tonë.

Plani Shumë-Vjecar i Veprimit të REA-s rrjedh nga angazhimet e ndërmarra në kuadër të CEFTA-s, Strategjisë 2020 të Europës Jug Lindore dhe bazohet në rregullat dhe parimet e BE-së sikurse

pasqyrohen në Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA), duke parashikuar zbatimin e veprimeve në nivelin e secilës prej vendeve pjesëmarrëse²⁹. Grafiku i mëposhtëm përshkruan fushat dhe objektivat e përcaktuara për secilën nga komponentët e [Planit Shumë-Vjecar të Veprimit](#)³⁰:

²⁹ [Consolidated Multi-annual Action Plan for a Regional Economic Area in the Western Balkans Six](#), 6 July 2017

³⁰ *Ibid.*

Figura 2: Plani Shumë-Vjeçar i Veprimit të Zonës Ekonomike Rajonale

Multi-annual Action Plan for a Regional Economic Area (MAP REA)			
I. Trade	II. Investment	III. Mobility	IV. Digital integration
I.1 Facilitation of free trade in goods	II.1. Regional investment agenda	III.1. Mobility of researchers	IV.1. Digital environment networks and services, connectivity and access
I.2 Harmonisation of CEFTA Markets with the EU	II.2. Formalisation of agenda through appropriate instrument(s)	III.2. Mobility of professionals	IV.2. Trust and security in digital services
I.3 Creating NTMs and TDMs-free region	II.3. Implementation and monitoring of investment reforms	III.3. Mobility of students and the highly skilled	IV.3. Digital economy and society
I.4. Facilitation of free trade in services	II.4. Promotion of WB as a common investment destination		IV.4. Digital economy and society, data economy, standards and interoperability, Innovation
	II.5. Diversification of financial systems to boost investment		
	II.6. Smart Growth		

Burimi: Plani i konsoliduar Shumë-vjeçar i Veprimit (MAP) për Zonën Ekonomike Rajonale (REA) në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor

PËRMBLEDHJE E KUADRIT INSTITUCIONAL

Zbatimi i suksesshëm i Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit dhe rrjedhimisht prodhimi i rezultateve konkrete kërkon komunikim të konsoliduar ndërmjet një game të gjerë bashkëpunëtorësh dhe monitorim të rregullt të progresit të arritur deri tani. Zbatimi i Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit nuk parashikon krijimin e ndonjë institucioni apo strukture të re. Përkundrazi, zbatimi, koordinimi dhe monitorimi i këtij plani bazohet në një strukturë ekzistuese institucionale dy-palëshe:

- Së pari, tek **Koordinatori Kombëtar**, një zyrtar i lartë i emëruar nga secili autoritet kombëtar që udhëheq zbatimin e Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit në nivel kombëtar³¹. Gjithashtu, për secilën nga komponentët e këtij plani janë

krijuar **Pikat e Kontaktit**, në nivel kombëtar.

- Së dyti, tek strukturat ekzistuese rajonale të tilla si:

Sekretariati i CEFTAs- përgjegjës për shtyllën e Tregtisë

Sekretariati i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) - përgjegjës për tri shtyllat e tjera të Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit.

Roli i të dy Sekretariateve është koordinimi i zbatimit të Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit, monitorimi i zbatimit të tij dhe informimi i rregullt i përfaqësuesve të Sherpas³², si dhe raportimi për progresin e bërë tek samitet vjetore ballkanike.

³¹ [Hartimi i Udhëzimeve për Qeverisjen, Koordinimin dhe Raportimin për Planin e konsoliduar Shumë-Vjeçar të Veprimit për një zonë ekonomike rajonale në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor](#), 18 dhjetor 2017.

³² Sherpas janë përfaqësues të Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të G7 (Kanada, Francë, Gjermani, Itali, Japoni, Britani e Madhe dhe SHBA) të cilët mbledhen për të gjitha çështjet që lidhen me axhendën e punës të Samitit dhe janë përgjegjës për procesin përgatitor që i paraprinë Samitit dhe mbikëqyrin negociatat lidhur me hartimin e

Përveç autoriteteve kombëtare, zbatimi i Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit kërkon një partneritet të fortë me sektorin privat në secilën nga vendet e rajonit, organizatat rajonale si CIF, BE si dhe donatorë aktivë që ofrojnë mbështetje në fushat e Planit të Veprimit (p.sh. Banka Botërore dhe BERZH. Raportimi për zbatimin e masave të Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit bëhet në ciklet gjashtëmujore:

- **Raporti Vjetor i Progresit** i cili përgatitet në mes të vitit dhe përmban një vlerësim të detajuar vjetor të progresit të bërë në secilën prej fushave të Planit përkundrejt objektivave dhe afateve të paracaktuara;
- **Raporti Përkohshëm i Progresit**, i cili hartohet në fund të çdo viti kalendarik.

Raportet do të përgatiten nga Sekretariati i RCC bazuar në inputet e ofruara kryesisht nga autoritetet kombëtare, si dhe ekspertët përmes grupeve të punës / platformave ekzistuese rajonale, të cilët veprojnë nën kujdesin e organizatave rajonale dhe ndërkombëtare. Duket se të pasurit "të një mendimi" mbi zbatimin e Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit është i kufizuar vetëm tek autoritet kombëtare, organizatat rajonale, BE-ja dhe donatorët e tjerë. Zbatimi, koordinimi dhe monitorimi i Planit është një ushtrim që hedh dritë mbi përfitimet dhe kostot që rrjedhin nga krijimi i një tregu të përbashkët rajonal.

PËRFITIMET E MUNDSHME DHE KOSTOT E ZONËS EKONOMIKE RAJONALE

Mësimi i nxjerrë nga procesi i Berlit është se integrimi në BE dhe bashkëpunimi rajonal funksionojnë kur ato sjellin rezultate konkrete që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve. REA ofron një mundësi për qytetarët, dhe kryesisht sektorin privat në vendet e Ballkanit Perëndimor për të vlerësuar përfitimet konkrete nga procesi i

integritimit në BE dhe bashkëpunimi rajonal. Ka një numër përfitimesh që rrjedhin nga krijimi i një zone të tillë ekonomike në rajon.

Së pari, REA inkurajon zbatimin e politikave që nxisin rritjen dhe promovojnë lidhjen mes ekonomive rajonale dhe BE-së. Krijimi i tregut rajonal zvogëlon pabarazinë që ekziston midis shoqërive rajonale dhe BE-së. REA është një nismë për të përshpejtuar bashkëpunimin ekonomik rajonal, i cili do të lejojë në mënyrë progresive lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve, investimeve dhe punëtorëve të kualifikuar, në përputhje të plotë me rrugëtimin e secilit vend drejt BE-së.

Së dyti, një integrim më i madh ekonomik do ta bëjë rajonin më tërheqës dhe konkurrues. Krijimi i REA-s transmeton një mesazh të fuqishëm se vendet e Ballkanit Perëndimor përbëjnë një treg prej 20 milionë konsumatorësh³³ me potencial të madh të pashfrytëzuar për thithjen e investime të huaja direkte, gjë e cila ndikon në rritje ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës. Gjithashtu, një zonë e tillë do të gjenerojë mundësi të reja për kompanitë e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor duke zhvilluar zinxhirë vlerash përtej rajonit. Përveç kësaj, REA do të garantojë integritimin brenda rajonit dhe BE-së në të njëjtën kohë, dhe meqenëse REA kërkon miratimin e protokolleve shtesë të CEFTA-s, ajo do të nxisë afrimin e rajonit me BE-në.

Duke promovuar risitë/inovacionin dhe axhendën dixhitale, integrimi rajonal ekonomik po e transformon modelin aktual të rritjes në një mënyrë të tillë që të përshtatet me epokën e dixhitalizimit në të cilin jetojmë. Në secilën prej samiteve ballkanike, një theks i veçantë i kushtohet konektivitetit njerëzor, i cili mundësohet nga mobiliteti/lëvizshmëria e profesionistëve, projektet infrastrukturore, dhe dixhitalizimi

³³ Komisioni Evropian - [Fact Sheet](#), Ballkani Perëndimor: Zona Ekonomike Rajonale, 12 korrik 2017.

ekonomik dhe shoqëror. Kjo do të thotë se REA do të kontribuojë në forcimin e mëtejshëm të kapitalit njerëzor si motor që shtyn përpara gjithë mekanizmin social.

Përveç kësaj, krijimi i një zone të tillë ekonomike do të përmirësojë aksesin e mallrave rajonal në tregjet evropiane përmes përmirësimit të kapacitetit të prodhuesve rajonal për tu adoptuar me standardet e BE dhe pengesat teknike për tregtinë. Për më tepër, REA do të ndihmojë rajonin për të tërhequr financime nga donatorë të tjerë. Me procesin e Berlinit dhe zhvillimin e REA-s, ambicia politike e BE-së për rajonin është rritur dhe kjo duhet të pasqyrohet edhe në burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur projekte konkrete.

Së fundi, REA do të institucionalizojë përpjekjet e vendeve të Ballkanit Perëndimor në kuadër të integritimit ekonomik dhe përafrimit me parimet e BE-së duke adoptuar një qasje, e cila imponon mbi marrëdhëniet ekonomike rajonale të njëjtat parime që këto vende do të duhej t'i përmbaheshin, nëse ata do të ishin anëtarë të BE-së. Në veçanti, zgjerimi i marrëveshjes së CEFTA-s në drejtim të miratimit të një mekanizmi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke përfshirë harmonizimin e standardeve dhe barrierave jo tarifore, tregtinë e lirë të shërbimeve, kapitalit dhe punës, do të përshpejtojë gatishmërinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor për anëtarësim në BE.

Zbatimi i Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit kërkon reforma të rëndësishme politike, pronësi nga vendet e rajonit, koordinim të ngushtë mes donatorëve dhe bashkëpunim më të madh me sektorin privat, veçanërisht me CIF dhe shoqatat e biznesit në secilën nga ekonomitë pjesëmarrëse. Të gjithë këto elementë do të mbështesin Ballkanin Perëndimor për të arritur qëllimet drejt krijimit të zonës ekonomike rajonale.

Sidoqoftë, zhvillimi i një zone ekonomike të lirë, megjithëse fuqimisht e mbështetur, mund të ketë disa kosto, të cilat nëse nuk menaxhohen siç duhet, mund të kenë pasoja me efekt pasues për ekonomitë kombëtare të vendeve të rajonit. Në këtë këndvështrim, sektori privat, nëpërmjet shoqatave të ndryshme të biznesmenëve në Shqipëri, aktualisht po tërheq vëmendjen mbi ndikimin që REA mund të ketë tek prodhuesit vendas³⁴. Ndonëse, është e vërtetë se konektiviteti dhe bashkëpunimi rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor po ndodh në një kontekst globalizuese, qeveria duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur prodhuesit vendas nga dobësimi i mundshëm si pasojë e hapjes së një tregu të tillë. Megjithëse qeveritë e vendeve të rajonit janë të angazhuara në reforma të vazhdueshme, tregjet e tyre janë larg standardeve të BE-së. Struktura prodhuese në rajon është e dominuar nga kompani të vogla, produkte që nga pikëpamja teknologjike kanë një zhvillim mesatare ose të ulët, dhe tregu është i mbizotëruar kryesisht në produkte me vlerë të ulët³⁵. Në rajonin e Evropës Jug Lindore, nga [100 kompanitë më të mëdha](#), vetëm 11 janë nga vendet e Ballkanit Perëndimor³⁶. Prandaj, karakterizuar nga një mjedis i brishtë ekonomik, përtej shkallës së papërfillshme të përpjekjeve individuale të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ekziston nevoja për nisma të përbashkëta rajonale.

³⁴ "[Industria përpunuese, një vit të vështirë edhe për 2018](#)", Intervistë me Arben Shkodra, Sekretarë i Përgjithshëm i Unionit të Prodhuesve Shqiptar, Revista Monitor, 19 janar 2018.

³⁵ Gazmend Qorraj, "[Drejt Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Rajonale: Ballkani Perëndimor në udhëkryq](#)", rishikuar, shkurt 2018, fq. 13.

³⁶ "[100 kompanitë më të mëdha në Evropën Juglindore 2017](#)", marrë 12 janar 2018.

NGA KONCEPTUALIZIMI I ZONËS EKONOMIKE RAJONALE TEK ZBATIMI I SAJ

Më 4 korrik 2018, në panelin ministror të Takimit të Ministrave të Ekonomisë në Samitin e Londrës, Sekretari i Përgjithshëm i RCC prezantoi raportin vjetor mbi zbatimin e

Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit të REA-s duke theksuar përparimin e shënuar deri tani. Siç tregohet në këtë [raport](#), [arritjet kryesore nga zbatimi i këtij Plani](#) paraqiten si më poshtë.

SHTYLLAT E PLANIT SHUMËVJECAR TË VEPRIMIT TË REA	ARRITJET PËR 2017 – 2018
TREGTIA	<ul style="list-style-type: none"> - Protokoll i Shtesë nr. 5 i Marrëveshjes CEFTA mbi Lehtësimin e Tregtisë është ratifikuar dhe ka hyrë në fuqi (prill 2018); - Marrëveshje për fillimin e negociatave për një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tregtare - Protokoll i Shtesë nr. 7; - Portali i Statistikave të Tregtisë CEFTA është populluar me të dhëna dhe është operacional.
INVESTIMET	<ul style="list-style-type: none"> - Miratimi i Axhendës së Reformës së Investimeve Rajonale (RIRA), axhenda e promovimit të investimeve të përbashkëta / rajonale; - Krijimi i platformës rajonale të tregjeve të kapitaleve dhe zhvillimi i një programi rajonal për diversifikimin e tregjeve të kapitalit; - Platforma e Investimeve Online është përgatitur dhe lançuar; - Progres i avancuar lidhur me përgatitjen e Strategjisë së Specializimit Smart (S3): krijimi i platformave të punës S3 dhe fillimi i procesit të hartimit të Udhërrëfyesit S3.
MOBILITETI/ LËVIZSHMËRIA	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëveshja për të hapur negociatat mbi Marrëveshjen e Njohjes së Ndërsjellë (MRA) të Kualifikimeve Profesionale për profesione të zgjedhura; Ekipi negociator kombëtar i emëruar zyrtarisht. - Parimet e pranuar për Modelin e Njohjes së Kualifikimeve Akademike; Ushtrimi i përbashkët mbi njohjen e kualifikimeve Akademike gjatë zbatimit; - Pozicioni i përbashkët i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Horizon Europe (draft) për krijimin e rrjetit të qendrave EURAXESS të rajonit; - Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në Open Science.
AXHENDA DIXHITALE	<ul style="list-style-type: none"> - Lancimi i Axhendës Dixhitale për Ballkanin Perëndimor; - Themelimi i një dialogu të strukturuar politik rajonal të nivelit të lartë mbi transformimin dixhital përmes Samiteve Dixhitale Ballkanike; Samiti i parë Dixhital u organizua në vitin 2018. - Marrëveshje për të vazhduar proceset e uljes së kostove të roamingut për mbulimin e plotë të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe zbatimin e Udhërrëfyesit midis vendeve të rajonit dhe BE-së; - Forcimi i kapaciteteve të sigurisë kibernetikë dhe ndërtimi i kapaciteteve të rrjetit të Ekipeve të Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike të Ballkanit Perëndimor; - Lancimi i dialogut rregullator vjetor të TIK midis Ballkanit Perëndimor dhe KE; - Integrimi i rajonit në strukturat dixhitale të BE-së; - Fillimi i raportit të fizibilitetit për infrastrukturën broadband brenda shtatorit, përmes mbështetjes së WBIF / IPA; - Rritja e ndërhyrjeve rajonale në çështjet e edukimit dhe aftësive dixhitale.

Megjithëse përparim i dukshëm është arritur, ende ekzistojnë shumë detyra³⁷, të cilat duhet të adresohen në të ardhmen e afërt, si:

- liberalizimi i shërbimeve tregtare;
- promovimi dhe zbatimimi i mëtejshëm i RIRA;
- Finalizimi i negociatave për njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale dhe marrëveshjes mbi modelin për njohjen e kualifikimeve akademike;
- Heqja e kostove roaming për konsumatorët e vendeve të rajonit;
- Avancimi i zbatimit të Axhendës Dixhitale të Ballkanit Perëndimor.

Masat e paraqitura në Planin Shumë-Vjeçar të Veprimit të REA-s janë të rëndësishme për t'u zbatuar plotësisht deri në vitin 2020, me disa zgjatje deri në vitin 2023, siç dëshmohet në raportin vjetor, me qëllim transformimin e zonës ekonomike rajonale në një realitet për qytetarët e Ballkanit Perëndimor. Pavarësisht nga afati kohor, REA përbën një aspekt themelor të bashkëpunimit rajonal, i cili shpie drejt një stabiliteti, bashkimi, rritje ekonomike dhe prosperiteti më të madh për rajonin.

Prandaj, për ta shndërruar REA-n një histori suksesi, nevojitet një bashkëpunim më i ngushtë në nivel vendor midis Koordinatorëve Kombëtar, Pikave të Kontaktit, ministrive të linjës dhe institucioneve relevante³⁸. Meqenëse, zbatimimi, koordinimi dhe monitorimi i zbatimit të Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit bëhet përmes të gjithë këtyre aktorëve të

përmendur, një bashkërendim më i mirë dhe bashkëpunim i ngushtë midis tyre do të kontribuonte në promovimin më të mirë të REA-s tek publiku i gjerë dhe zbatimin e tij në praktikë. Përveç kësaj, një ndjenjë pronësisë kombëtare mbi masat e ndërmarrura për zbatim, në kuadër të Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit është me rëndësi të madhe për sa i përket përfshirjes së këtyre masave në procesin e hartimit të politikave. Në këtë kontekst, secila nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e domosdoshme në mënyrë që të zhvillojë një mjedis të përshtatshëm që REA "të ndodhë".

REKOMANDIME

Zgjerimi ka të bëjë me bashkimin e tregjeve. Në këtë kontekst, perspektiva e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor nënkupton integrimin e 6 ekonomive të vendeve të rajonin në tregun e vetëm të BE-së. Si e tillë, REA përfaqëson një pjesë integrale të procesit të Integritimit në BE të këtyre vendeve dhe katalizator për rritjen ekonomike të rajonit. Por, industritë e Ballkanit Perëndimor nuk janë ende në gjendje të përballojnë konkurrencën, gjë e cila reflekton në deficite tregtare, borxh të jashtëm dhe mungesë të një hapësirë financiare për investimet publike.

Prandaj, rekomandimet më poshtë mund të jenë të nevojshme për t'u përfshirë në 'axhendën e ardhshme' në mënyrë që Zona Ekonomike Rajonale të bëhet një realitet i prekshëm për vendet e Ballkanit Perëndimor:

- Rezultatet në kontekstin e REA-s duhet të përshpejtohen dhe gjashtë vendet e rajonit duhet të thellojnë integrimin e tyre drejt një tregu të përbashkët për vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo është një 'detyrë shtëpie' për qeveritë e

³⁷ [Svilanovic: Progres i dukshëm i arritur në zbatimin e Planit Shumëvjeçar të Veprimit në Zonën Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor](#), 4 korrik 2018.

³⁸ [Raporti Vjetor mbi Zbatimin e Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor](#), qershor 2018, fq. 9

rajonit për të cuar përpara reformat e tyre ekonomike me qëllimin për të qenë pjesë e një tregu të përbashkët rajonal. Krijimi i një tregu të përbashkët rajonal është mënyra e vetme për të transformuar dhe prezantuar rajonin në një destinacion unik për thithjen e investimeve të huaja.

- Nevojitet një instrument i dedikuar financimi për vendet e rajonit, në funksion të nxitjes së integritit të gjashtë ekonomive të vogla në një treg të përbashkët rajonal dhe sigurimit të zbatimit të suksesshëm të Planit Shumë-Vjeçar të Veprimit. Duhet të kuptohet se, investimi për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor është një situatë ku nuk ka të humbur, gjë e cila është qartësisht në interesin tonë të përbashkët evropian. Kështu, mbështetja e ardhshme e BE-së për rajonin duhet të korrespondojë me ambicien e saj politike, ambicie që me procesin e Berlinit ka njohur zhvillim pozitiv. Nga pikëpamja praktike dhe e eficiencës, një instrument i dedikuar financimi për rajonin mund të jetë më i

përshtatshëm në aspektin e zbatimit, bashkërendimit dhe monitorimit, në vend të disa instrumenteve sikurse paraqitet situata aktuale (si IPA, WBIF, ERBD etj.)

- Gjithashtu, është me rëndësi të madhe që qeveritë e Ballkanit Perëndimor të përgatisin politikat e tregtisë së brendshme në mënyrë që të lehtësojnë përgatitjen e secilës ekonomi në kontekstin e "bërjes gati" për të vepruar në një treg të lirë. Si e tillë, është e rëndësishme që të bëhet një hartëzim i të gjitha industrive prodhuese, të cilat mund të ndihmojnë në identifikimin e asaj që po prodhohet pikërisht në secilën prej vendeve të rajonit, si dhe cilat produkte mund të konsiderohet me përparësi konkurruese për secilën ekonomi si në nivel kombëtar ashtu edhe atë rajonal. Qëllimi është që këto vende të bëhen më efikase në aspektin e prodhimit, në mënyrë të tillë që vendet e Ballkanit Perëndimor të konkurrojnë në të njëjtin nivel me njëri-tjetrin, si dhe me BE-në sapo tregu të liberalizohet.